

P Z A P  
I P Ž P



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 466/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Rafet Haxhaj kryesues, Vlastimir Dimić dhe Ferit Osmani, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 14.12.2010, mori këtë:

## V E N D I M

I. **Hidhet** poshtë ankesa si e palejuar e subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), sa i përket pjesës së ankesës që ka të bëjë përkitazi më KQZ.

II. **Refuzohet** ankesa si e pabazuar e subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), sa i përket pjesës së ankesës që ka të bëjë përkitazi më subjektin politik LDK.

## A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 12.12.2010, nga subjekti politik PDK, me te cilën pretendohet se më datë 12.12.2010, në KKZ në Podujevë ka pas parregullsi përgatitjen e procesit zgjedhor sepse nuk kanë funksionuar baterit fluroscente. Në ankesë poashtu theksohet se subjekti politik LDK, ka shpërndarë në ditën e zgjedhjeve mbi 200 bexha të falsifikuar dhe të pavulosur për vëzhguesit e tyre të cilët kanë vërvshuar në shumë Qendra të Votimeve..

Neni 59 paragrafi 2 i LZP-së, parasheh:

*59.2 KQZ-ja e Kosovës siguron përgatitjen dhe mbajtjen e zgjedhjeve në pajtim me parimet dhe kërkesat e këtij ligji.*

## Përgjegjësit dhe Funksionet e KQZ-së

Neni 64 i LZP-së parasheh:

*64.1 KQZ-ja është përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji*

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, nen 6 paragrafi 4 parasheh:

*Panellet vendim-marrëse mund ta refuzojnë me procedurë të shpejtë ankesën apo një grumbull ankesash, të cilat janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore apo ato të cilat sipas mendimit të tyre nuk paraqesin një rast prima facie . Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:*

**Neni 118 i LZP-së parasheh:**

*118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmblushin standarde*

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, nen 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh:

- (c) *hollësi rrëth qfarëdo dëshmie dhe kopje të qfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP-i ankesën e subjektit politik PDK e ka ndarë në dy pjesë dhe që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

**I. ankesa është e palejuar.**

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës sa i përket pjesës së ankesë që ka të bëjë përkiatzi me KQZ, se janë bërë shkeljet e theksuara në ankesë nuk janë nën juridikcionin e PZAP-it.

**II. ankesa refuzohet si e pabazuar**

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës sa i përket pjesës së ankesë që ka të bëjë përkiatzi me subjektin politik LDK, se janë bërë shkeljet e theksuara në ankesë nuk janë ofruar dëshmi për të besuar se shkeljet e tillë janë bërë nga subjekti politik LDK.

Prandaj PZAP-i, duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim më dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatë (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 466/2010 më datën 14.12.2010.

Kryesuesi i Panëlit  
Rafet Haxha